

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

03.11.2022

Ora 14:10

RENDI I DITËS

Projektakti “Për miratimin e rregullave për numërtimin e zonave të qendrave të votimit dhe qendrave të votimit”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Të tjerë: KRIK**

Znj. I. Nano: Mirëdita, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zyrtarë të tjerë të KQZ-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në rendin e ditë së mbledhjes së Komisionit Rregullator kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullave për numërtimin e zonave të qendrave të votimit dhe qendrave të votimit”. Paraprakisht më lejoni të pyes kolegët, nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të cilën duan të diskutojmë? Kolegë?!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

Nëse jo, fillojmë me paraqitjen dhe prezantimin e projektvendimit, i cili ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Merkaj, ju lutem prezantimin e projektaktit!

Z. Y. Merkaj: Neni 62 i Kodit Zgjedhor, autorizon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të numërtojë zonat e qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi, me udhëzim të veçantë. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ. Për këtë arsye po i propozojmë Komisionit Rregullator miratimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullave për numërtimin e zonave të qendrave të votimit dhe qendrave të votimit”. Sistemi unik i numërtimit (SUN) është miratuar me udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2009, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Përmes këtij sistemi realizohet numërtimi i vazhdueshëm i zonave të qendrave të votimit nëpërmjet një sistemi unik të papërsëritshëm, në rend rritës, nga qendra e parë e votimit, në veri të vendit, deri në qendrën e fundit të votimit në jug të vendit. Aktualisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve aplikon numërtimin katërshifror për qendrat e votimit siç udhëzon legjislacioni. Në rast të krijimit të qendrave të reja të votimit brenda së njëjtës zonë të qendrave të votimit (shkrirje apo ndarje të tyre), shtohen numrat nga “1” deri në “99”, me karakter ndarës ndërmjet numrit katërshifror dhe numrit që shtohet për identifikimin e një qendre votimi të re. Gjatë procesit të rakordimit të të dhënave të dërguara elektronikisht ose manualisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është përballur me shqetësimin e identifikimit të saktë të qendrave të votimit. Problematikat e adresuara kërkojnë që sistemi aktual i qendrave me numërtim katër, pesë dhe gjashtëshifror të unifikohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për të shmangur në të ardhmen pasaktësi apo problematika që lidhen me hedhjen e të dhënave, raportimin dhe përpunimin e tyre.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

Ky unifikim përkon edhe me sistemin e numërtimit që përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Nëpërmjet këtij projektvendimi propozohet që çdo qendër votimi të ketë numërtim gjashtëshifror. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ruhet numërtimi ekzistues i qendrave të votimit. Në rastin e qendrave të votimit numërtimi aktual i të cilave është katërshifror shtohet karakteri ndarës “/” dhe numrat “00”. Në rast se numërtimi aktual i qendrës së votimit është pesëshifror, atëherë përpara numrit të fundit shtohet karakteri ndarës “/” dhe pas tij shtohet “0”. Në rast se numërtimi aktual i qendrës së votimit është gjashtëshifror, atëherë pas katër shifrave të para vendoset karakteri ndarës “/”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj, duke qenë se në mbledhje nuk po shoh përfaqësues të partive politike, doja të pyesja nëse janë njoftuar dhe nëse kanë pasur komente lidhur me projektvendimin, para se të fillojmë ne shqyrtimin e tij.

Z. Y. Merkaj: Jo, kemi nisur projektvendimin para një jave, të gjitha partive politike. Dje kemi bërë njoftimin për mbledhjen e sotme, nuk kemi pasur asnjë sugjerim, apo vërejtje. Kemi një kërkesë nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike, për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitej në mbledhje dhe kërkonte shtyrjen e saj. Kemi komunikuar dhe nuk na kanë sjellë asnjë sugjerim.

Znj. I. Nano: Atëhere, fillojmë me shqyrtimin në parim të projektaktit. Sikundër Sekretari i Përgjithshëm prezantoi në mënyrë të përmbledhur projektaktin, kemi të bëjmë me një projektakt, i cili zëvendëson pas miratimit, një udhëzim të vitit 2009 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe synon unifikimin në numërtimin e qendrave të votimit, duke vendosur për secilën qendër një numër unik. Duke pasur

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

një sistem gjashtëshifror i ndajmë me një karakter ndarës vijë e pjerrët (/), pas katër shifrave të para, në mënyrë që të përfshihen në këtë sistem unik numërtimi edhe qendrat e reja që krijohen brenda një zone të qendrës së votimit. Kolegë, në parim keni diçka për projektvendimin?

Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë. Ka dhjetë pika, unë do të lexoj secilën.

Pika 1. Zonat e qendrave të votimit në territorin e Republikës së Shqipërisë numërtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të papërsëritshme nëpërmjet Sistemit Unik të Numërtimit (SUN).

Lidhur me këtë pikë, diskutime?

Nëse jo kalojmë në votimin e pikës 1!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

Pika 2. Brenda një zone të qendrës së votimit mund të ketë një ose më shumë qendra votimi.

Kush është dakord me këtë pikë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

Pika 3. Qendra e votimit numërohet me numër gjashtëshifror, me rend rritës në drejtimin veri - jug. Katër numrat e parë i korrespondojnë zonës së qendrës së votimit dhe dy numrat që pasojnë në rend rritës nga “01” deri “99”, tregojnë qendrat e votimit të krijuara brenda së njëjtës zonë. Ndërmjet katër numrave të parë dhe dy numrave të fundit vendoset karakteri ndarës vijë e pjerrët (/). Në zonat e qendrave të votimit ku ka vetëm një qendër votimi, numri i qendrës së votimit korrespondon me numrin e zonës së qendrës së votimit dhe pas karakterit ndarës vijë e pjerrët (/) vendoset “00”.

Kjo është pika e tretë, kolegë?

Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me pesë vota pro miratohet!

Pika 4. Numërtimi fillon me numrin “0001/00” nga Qarku Shkodër e përfundon në Qarkun Vlorë.

Kush është dakord me pikën 4?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me pesë vota pro miratohet!

Pika 5. Në rastin e bashkimit të dy apo më shumë qendrave të votimit, numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit.

Besoj dhe kjo u sqarua nga Sekretari i Përgjithshëm që të mos kemi ngatërresa në numërtimin e qendrave të votimit, pezullohet numri i qendrës së votimit të shkrirë.

Kalojmë në votimin e pikës 5!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

Pika 6. Në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ruhet numërtimi ekzistues i qendrave të votimit. Në rastin e qendrave të votimit numërtimi aktual i të cilave është katërshifror shtohet karakteri ndarës vijë e pjerrët (/) dhe numrat “00”. Në rast se numërtimi aktual i qendrës së votimit është 2 pesëshifror, atëherë përpara numrit të fundit shtohet karakteri ndarës vijë e pjerrët (/) dhe pas tij shtohet “0”. Në rast se numërtimi aktual i qendrës së votimit është gjashtëshifror, atëherë pas katër shifrave të para vendoset karakteri ndarës vijë e pjerrët (/).

Kolegë, kemi ndonjë diskutim për pikën 6? Nëse jo, kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

Kalojmë te **pika shtatë** “shfuqizimet”.

Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2009, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për numërtimin e zonave të qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi” shfuqizohet.


Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

Pika 8. Ngarkohen organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Kolegë? Po zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Unë do të kisha një propozim. Në kushtet kur mendoj dhe vlerësoj që ky akt mund të mos shtrijë efektet për zbatim vetëm te këto struktura të përmendura, për tek organet e qeverisjes vendore, apo Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mendoj që do të ishte më mirë, që kjo pikë të mos ishte pjesë e këtij akti. Në mënyrë që të mos e kufizonim fushën e zbatimit të këtij vendimi vetëm te këto organe që janë përmendur në këtë akt.


Znj. I. Nano: Pra, të vlerësohet nga organet, që detyrimi për ta, vjen nga kodi.

Z. D. Çaka: Po, që është Kodi Zgjedhor që përcakton detyrimin për zbatimin e tij.

Znj. I. Nano: Kolegë, lidhur me propozimin ka ndonjë koment?

Z. M. Çakaj: Ne po miratojmë një akt normativ, i cili sigurisht do t'i shtrijë efektet mbi disa institucione të caktuara. Së pari, ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila do të hartojë gjithë aktet e tjera. Edhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të hartojë aktin në zbatim të normave që kemi përcaktuar ne. Sigurisht do të ngarkohen dhe organet e qeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Në vijim të propozimit të kolegut, unë propozoj nëse ka organe të tjera, ose ka ndonjë formulim tjetër ku mund t'i shtrijë efektet ky akt, të shtohen dhe ato. Por, mua më duket korrekte pika 8 e administruar dhe nëse ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

ndonjë organ, apo institucion të identifikuar qartë, i cili do të ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, mund ta shtojmë. Nëse nuk mund ta identifikojmë dot tani, atëhere të gjejmë një formulim “si dhe organet e tjera të cilat do të preken nga miratimi i këtij akti”.

Znj. I. Nano: Atëhere, të dy propozimet t’i shkrijmë në një?! Zonja Koja, si mendoni?

Znj. M. Koja: E formulojmë me të dy propozimet, me propozimin e zotit Çaka dhe zotit Çakaj.

Znj. I. Nano: Atëhere do të votojmë riformulimin e pikës 8, duke shtuar togëfjalëshin që propozoi zoti Çakaj. Kalojmë në votim të pikës 8 me këto propozime! Ju lutem kolegë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me pesë vota pro miratohet!

Pika 9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S’ka

Me pesë vota pro miratohet!

Pika 10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.03.11.2022*

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet me pesë vota!

Pasi kemi miratuar në parim dhe nen për nen projektvendimin me ndryshimet përkatëse të propozuara gjatë mbledhjes, kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit!

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me pesë vota pro miratohet!

Atëherë sapo miratuam projektvendimin “Për miratimin e rregullave për numërtimin e zonave të qendrave të votimit dhe qendrave të votimit”. Duke qenë se nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës për të diskutuar, mbledhjen e Komisionit Rregullator e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 27

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

